



**Prindërve të nxënësve të shkallës së
dytë 1**

Ref. : ESa/JV/est

Lozanë, shtator 2019

Zonjë, Zotëri,

Së shpejti, fëmija juaj do të mbarojë shkollimin dhe më pas do t'i duhet të bëjë zgjedhje që do të përcaktojnë të ardhmen e tij.

Për t'ju mbështetur, juve dhe fëmijën, në reflektimin dhe përçapjet që do të bëni, keni në dispozicion një **psikolog këshillues në fushën e orientimit** në entin shkollor. Ai do të kalojë në klasë për të nisur apo për të vazhduar me nxënësit punën mbi procesin e orientimit. Mund të kërkojen edhe takime individuale, në të cilët jeni të mirëpritur.

Ju ftojme që paralelisht të përdorni edhe **mjetet e ndryshme të informimit** të vëna në dispozicionin tuaj për të mbështetur fëmijën në këto përçapje të rëndësishme :

- Seancën “Info-Métiers” (Informim mbi profesionet) (programi në shtojcë)
- Sallonin e profesioneve dhe të formimit që zhvillohet nga 19 deri në 24 nëntor 2019
- Qendrën e informimit mbi studimet dhe profesionet (QISP) të rajonit tuaj
- Dosjen “AMP” të shpërndarë në klasë (Mon avenir **m'appartient** - E ardhmja ime më përket mua)
- Fletëpalosjen “Parents, votre rôle dans l'orientation de votre enfant” (Prindër, roli juaj në orientimin e fëmijës suaj) (në shtojcë)
- Fletëpalosjen “Un stage, pour quoi faire ? Guide à l'usage des parents” (Një stazh, përse ? Udhërrëfyes për prindërit) (në shtojcë)
- Broshurën “La formation postobligatoire dans le canton de Vaud” (Formimi pas arsimit të detyrueshëm në kantonin e Vaudit) (në shtojcë)
- Sitin e Internetit **www.vd.ch/orientation**

Me gjithë dëshirë, do të qëndrojmë në dispozicionin tuaj për çdo informacion plotësues.

Duke ju falënderuar për vëmendjen që do të tregoni për sa sipër, na lejoni t'ju drejtojmë, Zonjë, Zotëri, përshëndetjet tona më të mira.

Shefi i entit shkollor/Shefja e entit shkollor

Shtojca : bashkëlidhur.

Kopje : Mësuesve kujdestarë dhe Drejtorive të enteve shkollore përkatëse.

- ▶ Përkthimin e kësaj letre mund ta gjeni në sitin e orientimit :
- ▶ Eine Übersetzung dieses Schreibens finden Sie auf der Website der Berufsberatung :
- ▶ You can find a translation of this letter on our Website :

◀ تتوافر الرسائل المترجمة إلى عدة لغات على موقعنا الإلكتروني :

- ▶ Podrá encontrar una traducción de esta carta en nuestro sitio web :
- ▶ Troverete una traduzione di questa lettera sul sito di orientamento :
- ▶ Podem também encontrar uma tradução desta carta no nosso sítio de internet :
- ▶ Prevod ovog pisma se nalazi na našoj veb strani :
- ▶ ጸደቅ ዝተተርጎመ ደብዳቤ ኣብ ናይ ምምክር ሞያ መርበብ ሓገራታ ክትረኽቡዎ :
- ▶ Bu mektupların değişik dillerde çevirilerini İnternet sitemizde bulabilirsiniz :

Les lettres traduites dans différentes langues sont disponibles sur notre site Internet :

www.vd.ch/orientation ➡ « Nos publications »